



KONTRATË MBI QIRANË

E lidhur në Deçan me dt. 02 Prill 2024, në mes të palëve:

1. Komunës së Deçanit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, në njërën anë, në tekstin vijues qiramarrësi.

Dhe

2. Z. Shpend Ahmetxhekaj nga fshati Isniq, Komuna e Deçanit, me nr. Personal _____, nga ana tjetër, në tekstin vijues qiradhënësi.

OBJEKTI I KONTRATËS

Neni 1.

Objekt i kësaj Kontrate është dhënia gjegjësisht marrja me qira e banesës e cila gjendet në qytetin e Deçanit, _____ me sipërfaqe 63 m², pronar i së cilës është z. Shpend Ahmetxhekaj nga fshati Isniq, Komuna e Deçanit dhe ia jap me qira qiramarrësit Komuna e Deçanit të cilën e përfaqëson kryetari z. Bashkim Ramosaj, me qira mujore prej 200€ (dyqind euro) në muaj, për 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe atë duke filluar nga data 02 Prill 2024 deri me 01 Tetor 2024. Banesë e cila merret me qira për nevojat e strehimit të familjes së _____ nga fshati _____, Komuna e Deçanit me nr. personal _____, bashkë me _____ si rast i rëndë social.

OBLIGIMET E KOMUNËS

Neni 2.

Qiramarrësi-Komuna e Deçanit sipas kësaj Kontrate ka për obligim:

- Që nga buxheti komunal të paguaj nga 200 € (dyqind euro) për çdo fund të muajit, në emër të qirasë mujore. Sipas marrëveshjes paraprake qiraja do të paguhet në emër të Shpend Ahmetxhekaj nga fshati Isniq, Komuna e Deçanit me numër personal _____ në xhirollogarinë me numër _____ ne Raiffeisen Bank.

OBLIGIMET E QIRADHËNËSIT

Neni 3.

Qiradhënësi – z. Shpend Ahmetxhekaj nga fshati Isniq, Komuna e Deçanit ka për obligim:

- Të ja jep me qira banesën e gjendet afër _____ me sipërfaqe 63 m², e cila banesë është pronë private e tij dhe ia jap me qira Komunës së Deçanit të cilën e përfaqëson, kryetari, z. Bashkim Ramosaj, me qira mujore prej 200 euro në muaj dhe atë prej datës 02 Prill 2024 deri me 01 Tetor 2024, për nevoja të strehimit të familjes së _____ nga fshati _____, Komuna e Deçanit si rast i rëndë social.
- _____

OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

Neni 4.

Palët e kësaj Kontrate duhet të angazhohen që të gjitha obligimet e përcaktuara në këtë Kontratë t'i zbatojnë me përpikëri, meqenëse kontrata është shprehje e lirë e vullnetit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 5.

Komuna do të kryej obligimet financiare që dalin nga kjo kontratë për çdo muaj, deri me dt.05 të muajit vijues do të bëhet pagesa për muajin paraprak.

Neni 6.

Kjo kontratë shkëputet me realizimin përfundimtar të saj, mirëpo mund të shkëputet edhe para afatit nëse palët nuk u përmbahen obligimeve që dalin nga kjo kontratë.

Neni 7.

Në rast të mosmarrëveshjeve eventuale palët do të përpiqen që të njëjtat t'i zgjedhin përmes bisedimeve të ndërsjella. Në rast se palët nuk arrijnë që mosmarrëveshjet ti zgjedhin me mirëbesim, atëherë për zgjidhjen e kontestit kompetent është Gjykata Themelore Pejë-Dega në Deçan.


Neni 8.

Kjo Kontratë është e hartuar në 3 kopje origjinale identike, prej të cilave nga një e marrin palët kontraktuese kurse me kopjet tjera do të pajisen organet kompetente.

Neni 9.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët .

E nënshkruar në Deçan, me dt. 02 Prill 2024.



Palët nënshkruese të Kontratës:

Qiradhënësi:
Shpend Ahmetxhekaj



Qiramarrësi:
Për Komunën e Deçanit
Kryetari Bashkim RAMOSAJ